



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË  
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 572 / Prot.  
3

Patos, më 22 / 03 / 2023

**PROCESVERBALI I TAKIMIT DATE 15.03.2023**

**Vendi:** Salla e mbledhjeve te Keshillit Bashkiak Bashkia Patos

**Ora e fillimit :** 10:00

**Ora e mbarimit :** 14:00

**Tema e Konsultimit:** “Ngritja e një vendi të përshtatshëm për tregtimin e produkteve bujqësore” Skema mbështetëse AZHBR

**Baza Ligjore:** Në zbatim të ligjit me nr.139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” nen 18; Ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 nen 5, pika 1,2,3 4 nen 52; Ligjit Nr. 119/2014. “Për Të Drejtën E Informimit” Rregullores së Këshilli Bashkiak “ Për konsultimin publik”, si dhe kërkesës së Bashkisë Patos me nr.572 prot datë 23.02.2023.

**Pjesëmarrës:** Kryetarja e Bashkisë znj. Rajmonda Balilaj, Sekretari i Këshillit Bashkiak Z.Balil Balilaj, Ekspert i Bujqësisë z. Ilir Pilku, Administratore e Njesisë Zharrëz znj. Polikseni Tupe, Koordinatorja e Konsultimit Publik znj.Suzana Hysenaj, Rreth 53 pjesëmarrës ( anëtarë të Këshillit Bashkiak, mësues, banorë të Njesisë Zharrëz dhe Ruzhdie, Kryetarë të fshatrarave dhe fermerë)

**Takimin hapet nga Kryetare e Bashkisë znj. Rajmonda Balilaj,** e cila falenderoi të gjithë për pjesëmarrjen në këtë takim konsultativ. Bashkia Patos për nga shtrirja e saj gjeografike, një nga

prioritetet kryesore të saj ka dhe do të mbeten mbështetja për fermerët, ndaj ne duam jo vetëm sot por në vazhdimësi konsultimin e cështjeve të rëndësishmë sic është “Ndërtimi i një tregu bujqësor” por edhe diskutimin e “Planit të përgjithshëm rural” pa harruar këtu edhe ngritjen e “Grupit vendor të veprimit” si një kërkesë e shuar dhe e kërkuar nga Bashkimi Europian. Për ngritjen e këtyre grupeve, së bashku me mua është edhe eksperti i lartë për bujqësisë dhe agrobiznesit z. Ilir Pilku, por edhe përfaqësues të “Noa” që është mbështetëse në këtë takim. Fjal është për z. Ilir



*Kryetare e Bashkise Znj.  
Rajmonda Balilaj*

*Degjesa Publike me te me:*

*“Ngritja e një vendi të përshtatshëm për tregtimin e produkteve bujqësore” Skema mbështetëse AZHBR*


*Patos 2023*

**Ekspert i bujqësisë dhe agrobiznesit z. Ilir Pilku:** – të nderuar të pranishëm, e nderuar Kryetare ju falenderoj për prezencën tuaj në këtë takim konsultativ. Ashtu sic e tha edhe kryetarja sot jem këtu për të diskutuar tema të rëndësishme që znj. Rajmonda prezantoi dhe që kanë të bëjnë me bujqësinë dhe grantet që Bashkimi Europian ofron për shtetin shqiptar përmes projekti IPARD 3 dhe investimet në tregun bujqësor në Bashkinë e patosit. Dhe janë shumë para të cilat Bashkimi Europian, i adeson për femerin shqiptar por problemi është që ne nuk dimë se si ti marrim dhe nëse nuk dimë do të ngelemi aty ku kemi qenë gjithmonë. Më vjen mirë që sot në këtë takim shoh të gjitha grupet e interesit, shoh anëtarët e këshillit bashkiak, kryetarët e fshatrave, bizneset bujqësore dhe agro përpunuesit dhe unë shoh edhe institucionet mikro financiare dhe kjo kuptohet që është një vlerë me vete e drejtueses së Kryetares së bashkisë e cila cdo llojë bashkëpunimi në dobi të komunitetit e pranon dhe e ka derën e hapur. Por le të kthehem i nё atё se cfarë do të dikutojmë sot, zhvillimin rural. Zhvillimi rural, zhvillimi bujqësor nuk ka ngjyra dhe përkatësi politike, pra ne këtu sot jemi një familje dhe qëllimi i familjes sonë është se si të zhvillojmë komunitetin, biznesin, të eci përpëra biznesi, për të patur sa më shumë para duke iu siguruar të ardhmen e berezave që do të vijnë.

Bashkia e Patosit nё muajt nё vazhdim do të hapi një zyrë me një ditë të përcaktuar për konsultim publik që do të thotë kushdo fermer agrobiznes i cili do të njohi më shumë dhe më thellë nga ajo që ne do të prezantojmë sot për tju dhënë ju informacion se ku janë aktivitetet dhe kushdo nga ju, i cili ka neojë për konsultim individual, do te jetë i lultur të vijë dhe një herë nё dy

javë në tetë orë ne do të jemi të përkushtuar në bashki për të marrë informacionin e detajar se si mund të aplikojmë në skemant mbështetëse IPARD dhe AZHBR. Unë kam pregetitur një material të thjeshtëzuar me qëllim që të jetë i quartë dhe i kuptueshëm për të gjithë ju.

**Ekspert i bujqësisë dhe agrobiznesit z. Ilir Pilku:** – prezanton materialin e pregatur mbi investimet me grante IPARD dhe AZHBR si dhe nevojën për ndërtimin e një tregu bujqësor.



### **Ekspert i bujqësisë dhe agrobiznesit z. Ilir Pilku**


#### **Degjesa Publike me te me:**

*“Ngritja e një vendi të përshtatshëm për tregimin e produkteve bujqësore” Skema mbështetëse AZHBR*

*Patos 2023*

**Kryetare e Bashkisë znj. Rajmonda Balilaj:-** faleminderit Ilir per këtë prezantim të detajuar. Sic dhe u tha nga eksperti Bashkia Patos ka hartuar planin e saj te veprimit i cili është një instrument dhe organizëm i ri si një kërkesë edhe e Bashkimit Eropian për të patur bashkia partner me përfaqësimin e shoqërisë civile por sidomos të atyre që merren me agrobiznes ku padyshim të gjitha palët kanë interes ekonomik. Lidhur mbi prezantimin e ekspertit pyetje, sygerime apo veërejtje.

**Fermer në njësinë Administrative Ruzhdie z.Fatmir Gllava** – E dëgjova me vëmendje ekspertin por kam përshtypjen se keni harruar një detaj të renddësishëmi cili ka të bëjë me documentin e tokës e cila sot edhe pse kanë kaluar tridhjetë vjet nuk është kadastruar



### **Fermer në njësinë Administrative Ruzhdie z.Fatmir Gllava**

#### **Degjesa Publike me teme:**


*“Ngritja e një vendi të përshtatshëm për tregimin e produkteve bujqësore” Skema mbështetëse AZHBR*

*Patos 2023*

**Kryetare e Bashkisë znj. Rajmonda Balilaj:-** unë e njoh këtë problem dhe e di qe nuk keni mundur të aplikoni ndaj ne jemi këtu pér t'ju ndihmuar në cdo procedurë që ju por edhe cdo fermer tjertër të marrin certifikatën e pronësisë pasi jemi pér të ndihmuar fermerët dhe bujqësitet tanë pasi ky është edhe qëllimi jonë përfitimi i sa më shumë fondeve nga skamat mbështetëse që Bashkimi Evropian jep pér fermerët shqipëtar pér zhvillimin e bujqësisë si një nga hallkat kyce të zhvillimit të ekonomisë ssë një vendi.

**Ekspert i bujqësisë dhe agrobiznesit z. Ilir Pilku:** – më lejoni të bëjë një ndërhyrje znj. Kryetare, padyshim që cdo investim mbështetës nga Bashkimi evopian por si fillim kerkohen ide kërkon edhe një bazë ekonomike dhe nga lindja e ideve fillon edhe zhvillimi. Ne st kem ftuar edhe përfaqësues të sistemeve mikro financiare të cilët do të janë mbështetës pér cdo fermer i cili do të kërkoj mbshtetje financiare pér të aplikar në këto skema. Nqse ndnjë nga përfaqësuesit e Noas do të thotë dicka?

**Përfaqësues i NOA z. Fatmir Nikollı :** prezanton skemat mbështetëse pér fermerët dhe agrobiznesin pa kolateral deri në 30 miljon lekë



**Ekspert i bujqësisë dhe agrobiznesit z. Ilir Pilku:** – kur flasim pér kredi të gjithë stepen por pyetja ime është e thjeshtë, fermerët mund ta mbyllin kredinë para kohe?

**Përfaqësues i NOA z. Fatmir Nikollı:** padiskutim që po dhe ndihma që ne ofrojmë pér fermerët fillon nga vlera i invstimit me 200 mijë lekë pér fermerët që janë me grant dhe jemi me 0 % kolateral

**Kryetare e Bashkisë znj. Rajmonda Balilaj:** -ju flenderoj pér prezantimin informues dhe ndihmën që ofroni pér fermerët tanë nga ana tjeter doja tju bëja me dije se në vitin 2022, ne kemi patur gra fermere të cilat kanë qenë përfituese të skemave mbshtetëse në grantet e ofruara. Edhe këtë vit ne do të fokusohemi në dy drejtime kryesore, gratë fermere dhe të rinjtë fermerë ku cdo aplikim do të bëhet nga bashkia. Dua të theksoj faktin që edhe Iliri përmendi që në bashki ka një

specialist por edhe eksperti do të jetë prezent për dhenien e ndihmës dhe marrjen e cdo informacioni dhe mundësie për të qenë aplikues dhe pse jo pëfitues. Le të jemi ne më shumë kërkes ndaj informacionit ndaj do të doja që Iliri të jetë kët prezent për cdo paqartësi.

**Drejtore e Integrimit Evropian dhe Koordinimit te Fondeve te huaja znj.Elda Goxhaj:** - e gjej me shmë interes dëgjesën e sotme, duke qenë se e kemi si drejtori detyrë funksionale të koordinojmë asistencën e huaj dhe atë vendase. Bashkia Patos ka një traditë të mirë në asistencën ndaj fermerëve të zonës dhe ka një praktikë të përthithjes së fondeve, ku janë rreth 1 milion euro që janë përthithur nga fermerët përmes aplikimeve të mëparshme. Bashkimi Evropian, si donatori më i madh, përmës IPARD na jep mundesinë të kërkojmë dhe të koordinojmë asistencën e duhur teknike në këtë sektor, ndaj jemi të hapur si drejtori për të bashkëpunuar dhe asistuar procesin.



**Drejtore e integrimit evropian dhe  
koordinimit te fondeve te huaja  
znj.Elda Goxhaj**

**Dëgjesa publike me temë:**

**“Ngritura e një vendi të përshtatshëm për  
tregtimin e produkteve bujqësore”  
Skema mbështetëse AZHBR**

**Patos 2023**

**Fermer i njësisë administrative Zharrëz z.Novruz Toska:** - ju falenderoj për prezantimin dua të theksoj dhe do të ndalem te ngritura e grupeve të fermerëve pasi është baza për grumbullimin të informacionit pasi gjykoj se është baza e përpnimit të informacionit për një fermer të sukseshëm duhet të ketë një bërthamë. Gjithashtu dua të ndalem pak te pjesa e dytë e prezantimit pasi po i mëshojmë më shumë faktit të aplikimeve që është i rendësishëm por ndërtimi i një tregu bjqësor është po aq i domosdoshëm dhe duhet të ishtë bërë më parë nga bashkia është investim i munguar



**Fermer i njësisë administrative  
Zharrëz z.Novruz Toska**

**Degjesa Publike me temë:**

**“Ngritura e një vendi të përshtatshëm  
për tregtimin e produkteve  
bujqësore” Skema mbështetëse  
AZHBR**

**Patos 2023**

**Fermer i njësisë Administrative Zharrëz z Ermal Hoxha:** ne kemi patur dhe vazhdojmë të kemi probleme me tokën por unë doja të dija a ka projekt për hapjen apo ngritjen e një laboratori për tokën?



*Fermer i njësisë Administrative  
Zharrëz z Ermal Hoxha:*


*Degjesa Publike me teme:*

*“Ngritja e një vendi të përshtatshëm  
për tregtimin e produkteve  
bujqësore” Skema mbështetëse  
AZHBR*

*Patos 2023*

**Ekspert i bujqësisë dhe agrobiznesit z. Ilir Pilku:** – pyetje interesante dhe ka projekte i cili kërkon një investitor pasi shkon në një vlerë tepër të lartë dhe për hir të së vërtetës jemi përballë domosdoshmërisë për të patur një laborator të tillë. Unë e bëj të mundur nëse dikush do që të bëjë një inestim të tillë kaq madhor. Por le të kthehemi pak edhe te pjesa e dytë e prezantimit ajo e tregut bujqësor por a na vlen, hajde ta diskutojmë dhe kjo është pjesë e diskutimit edhe me anëtarët e këshillit bashkiak me kryepleqtë të cilët do të jepin mendimin e tyre a ja vlen apo nuk ja vlen pasi shohim qendra tregu të ilat janë bosh dhe egjithë cështja është a na duhet një treg bujqësor

**Kryetare e Bashkisë znj. Rajmonda Balilaj:** tregu bjqësor është parashikuar në planin e përgjithshëm Vendor por ndoshta kur u hartua vëmendja në këtë drejtim nuk ka qenë edhe aq sa duhet dhe vërtet sot jemi përbëllë kësaj pyetje a duhet të ndërtojmë një treg bujqësor në Patos? Tregu është parashikuar në fshatin Verbas, por duke qenë se investimi do të jetë kolosal dua të marr mendimin tuaj përmes këtyre takimeve por pse jo edhe permes sondazheve nese duhet apo nuk duhet një treg bujqësor



**Kryetare e Bashkise  
z. Rajmonda Balilaj**


*Degjesa Publike me teme:*

*“Ngritja e një vendi të  
përshtatshëm për tregtimin e  
produkteve bujqësore” Skema  
mbështetëse AZHBR*

*Patos 2023*

**Fermer i Njësisë Administrative Zharrëz z.Novruz Toska:** - mendoj se vendi ëshë shumë i mirë pasi lidh Fierin Patosin dhe Rroskovecin

**Fermer i Njësisë Administrative Zharrëz z. Kozma Prifti:** lidhur mbi tregun mendoj se është investim i panevojshëm pasi kemi dy pika në Fier dhe nëse ndërtohet një treg i tillë në Patos si do të bëhet do të ulet cmimi?



**Fermer i Njësisë Adminnstrative  
Zarrëz z. Kozma Prifti:**

**Degjesa Publike me teme:**


*“Ngritja e një vendi të përshtatshëm  
për tregimin e produkteve  
bujqësore” Skema mbështetëse  
AZHBR*

**Patos 2023**

**Kryetare e Bashkisë znj.Rajmonda Balilaj:** - edhe unë kam qen në dilemë nëse do ti duhej bashkisë të invesonë në këtë drejtim por në qoftë se ju e keni gjetur tregun e sigurt, dikush tjetër mund ti mbetet prodhimmi pa shitur pasi nuk ka mundësi të gjej treg

**Ekspert i bujqësisë dhe agrobiznesit z. Ilir Pilku:** ne po flasim për një treg publik dhe jo privat po lasim për një treg me dhoma frigoriferike për ruajtjen e produktit bujqësor

**Fermer i njesise Zarrës z. Agron Doko:** kam idenë se të gjithë jemi në të njwjtin mendim që ne si fermerë kemi nevojë për një pikë grumbullimi të prodhimit dhe ruajtjes së tij.




**Fermer i Njësisë Adminnstrative  
Zarrëz z. Agron Doko :**

**Degjesa Publike me teme:**

*“Ngritja e një vendi të përshtatshëm për tregimin e produkteve bujqësore” Skema  
mbështetëse AZHBR*

**Patos 2023**

**Fermer i fshatit Verbas z. Vasil Cupa:** Ajo që unë doja të dija nëse ky treg bëhet nga kush do të administrohet



**Fermer i Njësisë Admnstrative  
Zarrëz z. Vasil Cupa :**

**Degjesa Publike me teme:**

*“Ngritja e një vendi të përshtatshëm  
për tregimin e produkteve  
bujqësore” Skema mbështetëse  
AZHBR*

**Patos 2023**

**Ekspert i bujqësisë dhe agrobiznesit z. Ilir Pilku:** - mesa po shoh pika e grumbullimmit rezulton te jete pikë debati se kush do ta menaxhoje ndërsa tregun është dicka më e madhe dhe për ju mund të jetë funksional jo vetëm në behar por për të gjithë vitin dhe ndoshta mund të përdoret edhe për zhvillimin e festave lokale për ti dhenë një frymë sa më kreative

**Kryetare e Bashkisë znj. Rajmonda Balilaj:** - unë e thashë edhe më parë qe mendimi i cdo fermer është i vlefshëm ndaj doja të dëgjoja edhe mendimin e fermërëve të tjerë të cilët nuk janë në këtë takim për shumë arsyë ndaj ne do të jemi në cdo familje me pyetsorë për të kupuar më drejtë orinentimin tuaj drejt këtij investimi pasi mesa kuptoj edhe nga takimet e përditshme që unë kam pjesa më e madhe e fermerëve kërkojnë treg bujqësor.

**Kryetar e fshatit Dukas z. Ilmi Myftari:** - unë mendoj se tregu duhet të bëhet në Patos dhe jo në Verbas pasi bashkia mund të shfrytëzojmë edhe objektet tw cilat janë në inventarin e saj me qwllim zvogwlimin e kostos sw invesstimit dhe kthimin e objekteve nw funksion pasi



**Kryetar i fshatit Dukas  
z. Ilmi Myftari**

**Degjesa Publike me teme:**

*“Ngritja e një vendi të  
përshtatshëm për tregimin e  
produkteve bujqësore” Skema  
mbështetëse AZHBR*

**Patos 2023**

**Kryetare e Bashkisë znj. Rajmonda Balilaj:** - Plani i përgjithshëm vendor është i miratuar dhe tregu duhet të jetë i akseseueshëm edhe nga fqinjët tanë pasi edhe unë e kam parë si mundësi njëren prej godinave të ndodhur në Dukas por pozicioni nuk është i favorshëm

**Ekspert i bujqësisë dhe agrobiznesit z. Ilir Pilku:** - ne nuk e përfundojmë këtu këtë bisedë dhe kjo temë mbetët e hapur për tu diskutuar edhe në takimet e tjera edhe përmes pyetesorëve sic tha edhe kryetarja të cilat do ti realizjmë në ditët në vijim. Nëse nuk keni ndonjë gje tjetër për të shtuar apo diskutuar unë doja tju falenderoj për cdo mendim të dhënë.

**Konceptoi:**

**Koordinator**

**Për Konsultimin Publik**

Suzana Hysenaj



**Miratoi:**

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**

Balil Balili

